



Влада на Република Северна Македонија

Në bazë të nenit 19 paragrafi (7) të Ligjit doganor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/05, 4/08, 35/10, 48/10, 158/10, 44/11, 53/ 11, 11/12, 171/12, 187/13, 15/15, 129/15, 154/15, 192/15, 23/16, 144/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më -----të vitit 2023, miratoi

VENDIM
PËR ULJEN E TAKSAVE TË IMPORTIT
PËR IMPORTIN E DOMATEVE, KRASTAVECAVE DHE SPECIVE TË FRESKËTA

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet masa për heqjen e taksës së importit – normë doganore dhe taksa të veçanta gjatë importit të domateve, krastavecave dhe specave të freskëta edhe atë:

Shenja tarifore	Përshkrim	Norma doganore (BO %)
0702 00	Domat, i freskët ose i ftohur:	
0702 00 00 11	- Nga 15 marsi deri më 31 dhjetor	10
0702 00 00 19	- Nga 01 janari deri më 14 mars	10
0707 00	Krastavecë dhe krastavecë të vegjël, të freskëta ose të ftohura:	
	- Krastavecë:	
0707 00 05 10	-- Nga 15 shkurti deri më 31 tetor	10
0707 00 05 90	-- Nga 01 nëntori deri më 14 shkurt	10
0709	Perime të tjera, të freskëta ose të ftohura:	
0709 60	- Specatë llojit Capsicum ose llojit Pimenta:	
0709 60 10 00	-- Specatë ëmbël	10
	-- Tjetër:	
	--- Tjetër:	
0709 60 99 10	---- Nga 15 maji deri më 14 nëntor	10
0709 60 99 90	---- Nga 15 nëntori deri më 14 maj	10



Влада на Република Северна Македонија


Neni 2

Mallrat nga neni 1 i këtij vendimi, do të importohen deri më 1 dhjetor të vitit 2024.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi me ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. _____ _____shtator të vitit 2023 Shkup		Kryetar u Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, dr. Dimitar Kovačevski, n.p.
--	--	---





Влада на Република Северна Македонија

A r s y e t i m

Me këtë vendim propozohet ulje e përkohshme e taksave të importit – normave doganore dhe taksave të veçanta gjatë importit të domateve, krastavecave dhe specave të freskëta edhe atë:

- Domat, i freskët ose i ftohur
- Krastavecë:
- Specat të ëmbël
- Specat djegës

Propozim vendimi për uljen e taksave të importit – normave doganore dhe taksave të veçanta për importin e domateve, krastavecave dhe specave të freskëta, propozohet me qëllim të uljes së çmimeve të këtyre produkteve në vend dhe mbrojtjes së standardit jetësor të qytetarëve.

Normat e rregullta doganore të këtyre produkteve variojnë deri në maksimum 65% (domate dhe specat të ëmbël) max 51% dhe 65% (specat djegës) max 60% dhe 65% (krastavecë).

Importi i këtyre produkteve bëhet pa doganë nga vendet anëtare të CEFTA-s dhe me doganë të paguar nga vendet e tjera.

Në përputhje me të dhënat e dorëzuara nga Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën nga 1 tetori i vitit 2022 deri më 28.02. të vitit 2023, është realizuar import i përgjithshëm i këtyre produkteve në vlerë prej 117.303.096 denarë, përkatësisht import dhe eksport preferencial prej 109.658.328 denarë dhe import jopreferencial, përkatësisht import me doganë të paguar eksporti prej 7.644.767 denarë.

Me këtë rast është arkëtuar doganë në vletë prej 44.960.829 denarë dhe TVSH në vlerë prej 8.506.085 denarë.

Në përputhje me simulimin e bërë nga Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëse do të merrej ky vendim, do të arkëtohej dogana në vlerë të përgjithshme prej 11.730.310 denarë dhe TVSH në vlerë prej 6.451.670 denarë ose gjithsej 18.181.980 denarë.

Implikimet fiskale sipas këtij simulimi do të ishin 33.230.519 denarë më pak doganë të arkëtuar dhe 2.054.415 denarë më pak TVSH.